



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr. 28/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 7 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.28/2026, e datës 05.06.2026, parashtruar nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 7 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Më datë 05.06.2026 në PZAP, është parashtruar ankesë e identifikuar si ZP.Anr.28/2026 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje në të cilën pretendohet se kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, njëherit edhe kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik në fjalë, ka publikuar një spot në rrjetin social facebook të tij lidhur me zgjedhjet e 7 Qershor 2026 dhe nga tërësia e spotit zgjedhor vërehet se në disa pjesë të caktuara të tij janë përdorur fëmijët për aktivitete zgjedhore politike me qëllim të përfitimit të votave në zgjedhjet e 7 Qershorit 2026.

Tutje në ankesë, ankuesi thekson së është e pakontestueshme se në spot vërehen fëmijë të moshës minore (nën moshën 15 vjeçare) ku kandidati në fjalë i ka keqpërdorur ata duke i vendosur në spot zgjedhor me qëllim të përfitimit të votave dhe se në këtë spot përveç keqpërdorimit të fëmijëve për aktivitet politik me qëllim të përfitimit të votave, vërehet në anën e djathtë të spotit edhe llogoja e subjektit politik dhe numri i saj për zgjedhjet parlamentare. Prandaj, veprime të tilla janë të ndaluara me legjislacionin në fuqi përkatësisht nenin 5, par.3 të Rregullës Zgjedhore 07/2024 dhe praktika gjyqësore e PZAP-së, konkretisht

vendimi i PZAP-së ZP.Anr.11/2026, në pjesën e fundit të saj thekson se “Paneli vlerëson se është i parëndësishëm fakti se prindi i saj nuk ka kundërshtuar pjesëmarrjen në tubim, por i rëndësishëm është fakti se e mitura në asnjë rrethanë nuk ka mundur të gjendet në aktivitet politik e aq më shumë që të ftohet të recitoj siç edhe ka ndodhur ngase ky veprim si u tha më lartë bie në kundërshtim me rregullat zgjedhore.” Pra, në praktikën e PZAP-së, është i rëndësishëm fakti se të miturit nuk duhen të gjenden në një aktivitet politik duke theksuar më tutje se “përfshirja e fëmijëve në fushata zgjedhore përben shkelje të të drejtave të tyre dhe se nuk është në interesin më të mirë të tyre që subjektet politike t’i angazhojnë në fushatat e tyre”. Andaj, duke u bazuar në këto rrethana, subjekti politik LVV kërkon nga PZAP që bazuar në legjislacionin në fuqi t’i shqiptoj subjektit politik PDK sanksionin në formë monetare.

Si provë në ankesë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur linkun: <https://www.facebook.com/>dhe CD e bashkangjitur.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik PDK kërkon nga PZAP që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pabazuar, për arsye se ankesa e ngatërron plotësisht objektin mbrojtës të normës me natyrën faktike të materialit të kontestuar, duke trajtuar figura vizuale sintetike si persona real të angazhuar në fushatën zgjedhore. Në rastin konkret, materiali i kontestuar paraqet përmbajtje vizuale të gjeneruar digjitalisht me figuracion familjar dhe me personazhe sintetike të cilat shërbejnë vetëm si mjete ilustruese të mesazhit politik për gjendjen ekonomike të familjeve, çmimet dhe përballimin e shpenzimeve ditore. Këto figura nuk janë persona të identifikueshëm, nuk janë fëmijë real të angazhuar në aktivitet politik dhe nuk paraqiten si pjesëmarrës në tubim, bartës të simbolikës partiake ose persona që kërkojnë votë për ndonjë subjekt politik.

Tutje, në përgjigje subjekti politik PDK thekson se objekti mbrojtës i nenit 5, par.3 të Rregullores Zgjedhore është personi nën moshën 15 vjeç, si subjekt real i së drejtës dhe jo si një figurë e gjeneruar digjitalisht, e cila ka vetëm funksion vizual në kuadër të diskursit politik dhe se dizpozita e cituar nga ankuesi nuk e ndalon përdorimin e skenave familjare, ilustrimeve digjitale ose figurave sintetike në materialet e fushatës, por e ndalon angazhimin e personave real në moshën 15 vjeç në fushatën zgjedhore. Në këtë kontekst nuk qëndron as referimi i ankuesit në praktikën e PZAP-së në rastin ZP.Anr.11/2026, kjo praktikë trajton prezencën faktike të një të miture reale në një tubim politik, ndërsa rasti konkret trajton figura vizuale të gjeneruara digjitalisht në një spot zgjedhor dhe për me tepër, ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë që në spotin e kontestuar është angazhuar ndonjë person real nën moshën 15 vjeç përkundrazi pretendimi i tij mbështetet vetëm në pamjen e përgjithshme të figurave të krijuara në mënyrë sintetike, duke e trajtuar perceptimin vizual si provë të angazhimit të fëmijëve në fushatë. Andaj, PDK pretendon së ankesa paraqet një lexim të gabuar të nenit 5, par.3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 dhe një përpjekje për ta shndërruar përmbajtjen vizuale sintetike në shkelje zgjedhore.

Duke u bazuar në këto rrethana, PDK kërkon nga PZAP që ankesën ta refuzoj si të pabazuar dhe të konstatoj se materiali vizual i kontestuar përmban figura të gjeneruara digjitalisht dhe nuk paraqet angazhim të personave nën 15 vjeç në fushatë zgjedhore në kuptim të nenit të lartcekur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore si dhe përgjigjen në ankese, gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se subjekti politik PDK nuk ka bere shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, i cili përcakton se *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve”*. Mbi bazën e provave me saktësisht fotografinë e paraqitur nuk mund të vërtetohet se fëmijët kanë qenë të pranishëm në një spot të publikuar për fushatë zgjedhore. Këto pretendime janë te paqëndrueshme për arsye se, në spotin e ofruar si provë, nuk mund të vërtetohet se pjesëmarrësit në spotin e lartpërmendur i publikuar nga kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, nga radhët e Subjektit Politik PDK, ka fëmijë nën moshën 15 vjeçare të angazhuar si pjesë e fushatës zgjedhore pasi që ky spot ne rrjetin social e gjeneruar ne mënyrë artificiale, nga i cili spot shihet se fëmijët janë në përcjellje të prindërve.

Paneli vlerëson se spoti i publikuar nga subjekti politik përmban pamje të gjeneruar ne mënyrë artificiale. Nga provat e administruara nuk është vërtetuar se personat e paraqitur si fëmijë në materialin e publikuar janë persona realë apo se kanë marrë pjesë faktikisht në aktivitete zgjedhore të organizuara nga subjekti politik. Për rrjedhojë, nuk është provuar se ka ndodhur përfshirja e fëmijëve në aktivitete politike në kundërshtim me rregullat zgjedhore.

Ne rrethanat e rastit konkret Paneli vlerëson se video janë gjeneruar ne mënyrë artificiale dhe nuk mund të konsiderohen si paraqitje autentike e fakteve ose ngjarjeve reale, andaj këto pretendime nuk mund të merren në konsideratë për të provuar faktin e publikimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes nga subjekti politik përkatës. Megjithatë, përmbajtja e paraqitur në video, për shkak të natyrës së saj artificiale dhe mungesës së autenticitetit, nuk mund të shërbejë si provë për vërtetësinë e ngjarjeve ose deklarimeve që paraqiten në të. Duke qenë se nuk janë paraqitur prova të tjera relevante dhe të besueshme që do të vërtetonin pretendimet e ngritura në ankesë, Paneli konstaton se nuk është provuar ekzistenca e shkeljes së pretenduar të fushatës zgjedhore dhe si rrjedhojë ankesa refuzohet si e pabazuar. Ne baze të nenit 117 par. 3 LZP, kur vendos për ankesat PZAP, bazohet në prova të qarta dhe bindëse. Andaj Paneli vlerëson se barra e provës i takon ankuesit, si dhe pretendimet për shkelje zgjedhore duhet të mbështeten me prova të besueshme, autentike dhe të verifikueshme.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga prova e ofruar si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtruesit nuk përben shkak për shkeljet e pretenduara, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 te LZP-së, nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores NR.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.28/2026 më datën 06.06.2026

Kryesues i Panelit

Ramish Bardhi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.